



SHPALLJE PËR REKRUTIM EKSPERTËSH TË JASHTËM

Autoriteti i Mediave Audiovizive në mbështetje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 57 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" kërkon të rekrutojë 1 (një) ekspert të jashtëm i cili do të përfshihet në Njësinë e Prokurimit për objektin e prokurimit: "Rikonstruksion i godinës me emërtimin Atelier për dekorin e Radio-Televizionit të kaluar në përgjegjësi administrimi tek Autoriteti I Mediave Audiovizive dhe përshtatje për zyrat e AMA-s".

TERMAT E REFERENCES

Objektivi

Hartimi i dokumentave të tenderit, ndjekja e procedurës së prokurimit deri në lidhje të kontratës me objekt "Rikonstruksion i godinës me emërtimin Atelier për dekorin e Radio-Televizionit të kaluar në përgjegjësi administrimi tek Autoriteti I Mediave Audiovizive dhe përshtatje për zyrat e AMA-s".

Detyrat

Eksperti do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin e Mediave Audiovizive, për realizimin e detyrave të mëposhtme:

-Me kërkesë të AMA-s dhe në bashkëpunim të ngushtë me stafin, eksperti do të angazhohet në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 (i ndryshuar) "Për prokurimin publik" si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";

Periudha e zbatimit të detyrave:

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë deri në lidhje të kontratës me objekt "Rikonstruksion i godinës me emërtimin Atelier për dekorin e Radio-Televizionit të kaluar në përgjegjësi administrimi tek Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe përshtatje për zyrat e AMA-s".

Kualifikimet dhe aftësitë e ekspertit në Njësinë e Prokurimit:

- Diplomë e integruar ose ekuivalenti i saj në Inxhinieri Ndërtimi;
- Eksperienca të mëparshme në formulim të detyrave të ngjashme.

Produktet dhe materialet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Eksperti do të paraqesë në gjuhën shqipe të gjitha propozimet, rekomandimet, dokumentet e hartuara në AMA.

APLIKIMET MBYLLEN MË DATË 21 KORRIK 2016, ORA 10:00.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda këtij afati pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Adresa: Rruga "AbdiToptani", Tiranë